



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 111, Datë 29.03.2021**

**PËR**

**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E NGRITJES  
NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN  
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME  
VENDIMIN NR.89, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
  1. Znj. {...};
  2. Znj. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}dhe znj. Daniela Shirka, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**